



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 5.11.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR PERSONAT E ZHDUKUR (ICMP)”

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 5 nëntor 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe komisionit ndërkombëtar për personat e zhdukur (ICMP)”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Spartak Braho. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, si dhe në nenin 18 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP).

Kjo marrëveshje synon intensifikimin e përpjekjeve për gjetjen e personave të zhdukur, dhe veçanti personat e zhdukur gjatë periudhës komuniste në Shqipëri.

Sipas parashikimeve të marrëveshjes, Komisioni Ndërkombëtar për personat e zhdukur do të krijojë një zyrë shërbimi në Tiranë për gjetjen e personave të zhdukur, duke përdorur metoda tekniko-shkencore të zbulimit e të identifikimit, duke shkëmbyer informacionin dhe duke koordinuar me organet kompetente shqiptare .

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

-Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

-Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi me votat e shumicës së anëtarëve dhe vendosi t'ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATOR

Spartak BRAHO

KRYETARI

Ulsi MANJA